



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:123246
Datë: 09.09.2022
Numri i dokumentit: 03407215

C.nr.888/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Mirjeta Shala, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit K.N nga Prishtina... pa numër të cilën me autorizim e përfaqëson i autorizuari Korab Bokshi-avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 428.00 €, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të autorizuarit të paditurës, me datë 17 gusht 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit K.N nga Prishtina me të cilën ka kërkuar që të “DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit K.N nga Gjakova të ia paguajë në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 01.09.2019 e deri me datë 31.05.2021, respektivisht për 214 ditë të pranisë në punë, në shumën prej 428.00 € me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të fillojë të llogaritet nga data 16.06.2021 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit”

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi K.N nga Gjakova, përmes të autorizuarit të tij Ylli Bokshi, avokat në Gjakova, në këtë gjykatë me datë 16.06.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë duke theksuar se i njëjti është i punësuar pranë të paditurës dhe atë në shkollën e mesme të ulët “Prenk Jakova” në Gjakovë. E paditura ka pasur obligim sipas kontratave kolektive që paditësit të i’a paguajë ushqimin ditor, por këtë nuk e ka bërë. Meqë e paditura, nuk e ka kompensuar paditësin për këto shpenzime, i njëjti e ka iniciuar këtë kontest gjyqësor.

I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë pretendimeve të parashtruara në padi dhe nga seanca e kaluar, ashtu që pas

prapësimi të palës së paditur në kuptim të parashkrimit të kërkesë padisë, e kemi zvogëluar kërkesë padinë për periudhën kohore jo më larg se 3 vite nga momenti i paraqitjes së padisë, përkatësisht nga dt. 01.09.2018 deri me 31.05.2021, ashtu që në bazë të vërtetimit të lëshuar nga vet e paditura për atë periudhë kohore rezulton se paditësi ka vijuar 214 ditë pune e që në përputhje me kontratën kolektive, për secilën ditë të pranisë në punë i takojnë nga 2 €, në emër të shpenzimeve të ushqimit, apo shumën prej 428,00 €, me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga data 16.06.2021 e deri ne pagesën definitive, nen kërcenim te përmbaramit, ndera lidhur me kërkesën e paditësit për kompensimin e shpenzimeve te ushqimit i njëjti është tërhequr.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë: taksën gjyqësore për padi në vlerë prej 30.00-€, për përpilimin e padisë prej 78.00€, dhe për përfaqësim në dy seanca gjyqësore nga 101.00€ (për dy seanca 202.00), apo në shumën e përgjithshme 310.00€.

Përfaqësuesi i të paditurës në përgjigjen në padi të ushtruar me datën 07.06.2022 ka cekur se Kontrata Kolektive e Arsimit e nënshkruar në mes të MASHT-it e datës 22.01.2021 në nenin 47 të saj, ka shfuqizuar kontratën kolektive të datës 18.04.2017, ashtu që sipas nenit 35 par. 7 të kësaj kontrate si dhe lidhur me këtë dhe dispozitat kalimtare të nenin 45 par.1 nuk është bërë kurrfarë ndihmese në planifikimin e buxhetit për realizimin e kërkesave lidhur me zbatimin e dispozitave të nenit 35 par.7 deri sa të krijohen mundësitë financiare në Buxhetin e Republikës së Kosovës por jo ma vonë se viti 2023, po ashtu edhe sipas Qarkores Buxhetore 2022/01 i datës 14.05.2021, te granti specifik të arsimit para universitar, nuk është paraparë mundësia për realizimin e kësaj të drejte si dhe qe njëjta për një periudhe është e parashkruar. Mbi këtë bazë, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesë padinë e paditëses si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, ashtu që i ka propozuar Gjykatës që të merr Aktgjykim dhe të njëjtën ta refuzojë si të pa bazuar.

Tutje e paditura me parashtresën e datës 07.07.2022 gjykatës i ka dorëzuar dëshmi në lidhje me vërtetimin e punësimit të paditësit K.N nga Prishtina, duke theksuar se i njëjti është i punësuar në këtë institucion arsimor, përkatësisht shkollën e mesme të ulët të muzikës ” Prenk Jakova” dhe se i njëjti pranë saj ka normë sekondare të punës. Bashkangjitur gjykatës i ka dorëzuar vërtetimin me numër... të datës... duke shtuar se i njëjti pranë kësaj shkolle punon 10 orë mësimore në javë dhe se mbanë pagë sekondare.

Gjykata në kuptim të nenit 423 par.3 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në seancën shqyrtimin kryesor-publik i administroi këto prova: Kontratat e punës të lëshuara nga Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, e dt....Vërtetimi i lëshuar nga SHMUM “Prenk Jakova” me nr... e dt..., Vërtetimi i lëshuar nga SHMUM “ Prenk Jakova”, me nr. prot... dt..., Lista e pagës e lëshuar nga BRT dt..., Vërtetimi i lëshuar nga SHMUM “Prenk Jakova” me nr. protokollit... dt....

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore,(më tutje LPK-së), arriti në përfundim se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Kontratat e punës të lëshuara nga Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, e dt..., gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi K.N është në marrëdhënie pune te e paditura Komuna e Gjakovës–Drejtoria e Arsimit, respektivisht në Institucionin Arsimor: Shkolla e mesme e ulët e muzikës “Prenk Jakova” në Gjakovë, dhe punën e zhvillon me 10 orë mësimore të rregullta në javë.

Nga vërtetimi i lëshuar nga institucioni arsimor SHMUM “Prenk Jakova” me nr... i datës..., gjykata vërtetoi faktin se paditësi është i punësuar në këtë institucion arsimor që nga viti 2007 e tutje me 10 orë mësimore në javë.

Nga vërtetimi i lëshuar nga institucioni arsimor SHMUM “Prenk Jakova” me nr. të protokollit... të datës 10.06.2021 gjykata vërtetoi se paditësi për periudhën kohore nga data 01.09.2018 e deri më datë 31.05.2021 ka realizuar 214 ditë të pranisë në punë.

Nga lista e pagës e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës e datës 28.06.2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësi është i punësuar si nënpunës i ri me pagë sekondare.

Vërtetimi i lëshuar nga SHMUM “Prenk Jakova” me nr. protokollit... i datës..., gjykata vërtetoi faktin se paditësi në këtë institucion arsimor punon me 10 orë mësimi – (20 orë në javë) dhe realizon të ardhura sipas pagës sekondare.

Me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës 01/B e cila ka hyrë në fuqi me datën 22.01.2021, në mënyrë identike parashihet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.* Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësi është i punësuar te e paditura, përkatësisht në institucionin arsimore Shkolla e Mesme e Ulët e Muzikës “Prenk Jakova” në Gjakovë. Në këtë shkollë paditësi është i punësuar me 10 orë mësimi, përkatësisht 20 orë pune në javë, dhe atë me marrëdhënie pune sekondare, fakt ky i vërtetuar me vërtetimin me nr.5/928 të datës 06.07.2022 të lëshuar nga SHFMU “Prenk Jakova” si dhe nga vërtetimi i lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës të datës 28 qershor 2022. Duke u nisur nga të sipër cekurat, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore me të cilat është e theksuar se kompensimi i shpenzimeve të ushqimit prej 2 Euro në ditë ju njihet vetëm mësimdhënësve të cilët kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, dhe për faktin se paditësi nga provat në shkresat e lëndës, është vërtetuar se i njëjti në këtë institucion arsimore ka marrëdhënie pune sekondare, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit nuk është e themeltë dhe mbi këtë bazë vendosi për ta refuzuar në tërësi si të pa bazuar në ligj.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 463 par. 1 dhe 2 të LPK-së sipas të cilit “*Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën*”, andaj pasi që i autorizuari i të paditurës në përgjigje në padi ka theksuar se i kërkon shpenzimet por që të njëjta nuk i ka specifikuar, u vendos si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.888/2021, datë 17 gusht 2022

Gj y q t a r j a,
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita vijuese pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.